



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË**

**TË DREJTAT E STUDENTËVE**

Studentët kanë të drejtë:

- a) Të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- b) Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
- c) Të kërkojnë orë suplementare konsultimesh me pedagogët e lëndëve për çfarëdolloj problem që ka paqartësi apo kërkon mbështetje akademike.
- d) Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e institucionet parashikuar për studentë, në përputhje me këtë ligj dhe statusin e institucionit;
- e) Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit.
- f) Të paraqesin kërkesa dhe ankime (me gojë e me shkrim) tek Drejtuesi i departamentit për vlerësimet në provime, mësimdhënien, lektorët apo efikasitetin e programeve akademike.
- g) Të përdorë pajisjet e universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit;
- h) Të përfaqësohet në senatin e universitetit në përputhje me rregulloret përkatëse të këtyre organeve.
- i) Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse;
- j) Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të këshillit të ministrave, senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare;
- k) Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e senatit apo në aktet e posaçme të ministrisë së arsimit dhe të shkencës.
- l) Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- m) Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, të mosrealizimit të procesit të mësimdhënies, të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
- n) Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
- o) Të drejta të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Statutin e Universitetit "Ismael Qemali" të Vlorës dhe në këtë Rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË**

**PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE**

Studenti është i detyruar:

- a) Të njohë me hollësi rregullat e fakultetit e detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt, fakulteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- b) Të njohë të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë;
- c) Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga statuti i universitetit, nga kjo rregullore dhe nga çdo akti tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë;
- d) Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve, si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt fakultetit dhe universitetit, sipas përcaktimeve ligjore;
- e) Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të shkollës nga ana e tij; dëmi material që ai mund të ketë bërë zhdëmtohet në masën e përllogaritur.
- f) Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- g) Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- h) Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.